



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A
DREJTORIA LIGJORE

Data 15.08.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Paisje rrjeti Core (Firewall + Switch+Core Router) ne HQ dhe degët e shoqërisë, licensa për akses në distancë, mbrojtje rrjeti dhe paisjesh”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
72200000-7 Programim të programeve kompjuterike dhe konsulence**

VLERA E FONDIT LIMIT: 25,600,000 (njëzetë e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë, pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3**; në vlerën **512.000** (pesëqind e dymbëdhjetë mijë)

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, **sipas shtojcës 9**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore **për tre vitet e fundit financiare, nga data e publikimit të Njoftimit të Kontratës së Shpallur** në vlerën prej jo më pak se 95% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e Xhirove vjetore

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kërkohej 95% e vlerës së parashikuar të kontratës, duke mos limituar pjesëmarrjen edhe të biznesit të vogël, bazuar në pikën 2/b të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi kjo është një procedurë e Hapur- Ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët Monetar, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë **tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në një vlerë jo më të vogël se **39 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **39 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kapaciteti Teknik

2.3.2 Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- ISO 9001:2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)/ekuivalente
- ISO 27001 (për Sigurinë e Informacionit) ose ekuivalente.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e Certifikatave

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik ofertues në kete procedure, secili prej operatoreve ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO të renditura në pikat 1-3 më lart, sipas zërave të shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë në akt marrëveshjen midis palëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor për të vërtetuar se mallrat/ shërbimet objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund të kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standardet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera

fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/distributori, ku të autorizohet operatori për shitjen e produkteve hardëare dhe softëare të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit.

- Ky kriter plotësohet me dorëzimin e Autorizimit nga Prodhuesi/distributor i autorizuar.

(Ky kriter vendoset për të vërtuar që OE është i autorizuar nga prodhuesi për të prokuruar mallin objekt prokurimi, në respektim të mënyrave të parashikuara nga LPP, me qëllim që artikujt e kërkuar të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe cilësore të kërkuara).

Argumentim: Kërkesa për Autorizimin nga Prodhuesi/distributori ose akt marreveshje bashkëpunimi ose leter angazhimi me firmen prodhuese, është kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 , pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë kapacitete teknike dhe profesionale të mjaftueshme dhe burimin e furnizimit pasi këto artikuj nuk janë artikuj që janë shumë të kërkuar dhe që mund të gjenden lehtësisht në treg si dhe referuar specifikave dhe rëndësisë së veçantë që kanë këto artikuj objekt prokurimi.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të ketë të punësuar specialistë të çertifikuar të cilet plotësojnë kriteret në vijim:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist të çertifikuar për menaxhim projektesh.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

- Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar: Certifikatën e punonjësit/, Formularët E-Sig (3 muajt e fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur)

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Duke qenë se projekti që kërkohet të realizohet nga OE është kompleks, i një rëndësie të veçantë, me disa faza, operatori ekonomik duhet të ketë patjetër 1 person të certifikuar si manaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm dhe me rigorozitet të projektit në çdo fazë të tij.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) specialistë të çertifikuar për implementimin e pajisjeve Fireëall të ofertuar ose ekuivalent, të lëshuara nga një

organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

- Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar: Certifikatën e punonjësit/, Formularët E-Sig (3 muajt e fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur)

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Duke qenë se objekt i procedurës së prokurimit janë edhe pajisje të nivelit Fireëall, është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij specialistë të çertifikuar nga prodhuesi për të mundësuar instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë të pajisjes së Fireëall. Në këtë mënyrë garantohe mi se zgjidhja e ofertuar nga OE të implementohet me sukses dhe do të garantojë funksionalitet të plotë, performancë optimale dhe do të mirëmbahet gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Kjo kontratë ka për detyrë instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes fireëall, pra është e nevojshme që Operatori ekonomik të ketë staf të çertifikuar për instalimin dhe konfigurimin e kësaj paisjeje.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) specialist të çertifikuar në nivel profesional per rrjetin CCNP (ose ekuivalent) për implementimin e zgjidhjes sëitch, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

- Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar: Certifikatën e punonjësit/, Formularët E-Sig (3 muajt e fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur)

Arsyetimi: Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që ka staf teknik të kualifikuar për realizimin e kontratës. Specialisti i çertifikuar në nivel profesional për rrjetin garanton Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i çertifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizen e duhur profesionale për realizimin e kontratës, për zerat respektiv të prokurimit. Niveli i kërkuar profesional garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara për realizimin e kontratës. Kërkesa e mësipërme është

përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41/4 e VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Kjo kontratë ka për detyrë instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes Sëitch, pra është e nevojshme që Operatori ekonomik të ketë staf të certifikuar për instalimin dhe konfigurimin e kësaj pajisjeje.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) ekspert me njohuri të avancuara në fushën e sigurisë së informacionit të diplomuar në nivel master në Siguri Informacioni, për të dëshmuar që posedon njohuri të avancuara në sigurinë kompjuterike dhe të rrjetit fizik dhe me valë, vlersimin dhe menaxhimin e sigurisë, reagimi ndaj incidenteve të riskut, sigurinë e infrastrukturës kritike të informacionit dhe aspektet ligjore të sigurisë së informacionit.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

- Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar: Certifikatën e punonjësit/, Formularët E-Sig (3 muajt e fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur)

Arsyetimi: Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që ka staf teknik të kualifikuar për realizimin e kontratës. ekspert me njohuri të avancuara në fushën e sigurisë së informacionit të diplomuar në nivel master në Siguri Informacioni garanton Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës, për zerat respektiv të prokurimit. Niveli i kërkuar garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara për realizimin e kontratës. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41/4 e VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Kjo kontratë ka për detyrë instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes fireëall, pra është e nevojshme që Operatori ekonomik të ketë staf të certifikuar për instalimin dhe konfigurimin e kësaj pajisjeje si dhe politikave të sigurisë .

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) specialist të certifikuar të certifikuar CISSP, (Certified Information Systems Security Professional), ose ekuivalent, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

- Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar: Certifikatën e punonjësit/, Formularët E-Sig (3 muajt e fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur)

Arsyetimi: Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që ka staf teknik të kualifikuar për realizimin e kontratës 1 (një) punonjës i certifikuar CISSP, (Certified Information Systems Security Professional), ose ekuivalent është garanci për Autoritetin

Kontraktor që zhvillimi i testeve dhe vlerësimi i sigurisë së sistemeve të informacionit të realizohet në kohë me cilësi dhe sipas standardeve ndërkombëtare.

Ky certifikim garanton AK që OE ka në stafin e tij punonjës të certifikuar në fushën e sigurisë së informacionit të cilët zotërojnë njohuritë e nevojshme për të kuptuar gjithë aspektet e sigurisë së informacionit dhe aftësitë për ti zbatuar ato në praktikë. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41/4 e VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Kjo kontratë ka për detyrë instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes fireëall, pra është e nevojshme që Operatori ekonomik të ketë staf të certifikuar për instalimin dhe konfigurimin e kësaj paisjeje.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar per Endpoint Security Protection Trellix ose ekuivalent.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

-Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar: Certifikatën e punonjësit/, Formularët E-Sig (3 muajt e fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur)

Arsyetimi: Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që ka staf teknik të kualifikuar për realizimin e kontratës. Specialisti i certifikuar në Endpoint Security Protection Trellix garanton Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës, për zerat respektiv të prokurimit. Niveli i kërkuar garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara për realizimin e kontratës. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41/4 e VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Shenim:

Specialistët e certifikuar, vlerësohen të nevojshëm për arsye se: Bazuar në parashikimet e specifikimeve teknike, Operatori ekonomik fitues do të realizojë dhe upgrade të rrjetit ekzistues duke furnizuar pajisje te reja Fireëall, Sëitch të përshtatshme për komunikime sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktues.

Lidhur me disponimin në stafin e operatorit ofertues të specialistëve të certifikuar, Një punonjës mund të ketë 1 (një) ose disa certifikime për të përmbushur kriteret më lart.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76 “**Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit**”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:
 - a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
 - b) **studimit të tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
 - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
 - ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga strukturë e posacme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT